




VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNO ëSHTE
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ / UROŠEVAC

Më
Dana

04 - 05 - 2018

P.nr.243/18



GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, me zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED], i akuzuar sipas Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2409-8/17 të datës 02.02.2018, për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.2409-8/17 të datës 02.02.2018, për dhënen e urdhrit ndëshkimore dënim me gjobë, gjykata me dt. 15.03.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET, kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2409-8/17 të datës 02.02.2018, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED], i lindur më [REDACTED], me nr. personal [REDACTED], me vendbanim në Ferizaj rr. [REDACTED] nr. [REDACTED] ka të kryer shkollën e mesme, me profesion tregtar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

Se me datën 12.11.2017, rrëth orës 13:20, në rrugën “Zenel Hajdini” në Ferizaj, duke e drejtuar automjetin të markës “VW Tauran”, me ngjyrë hiri, me targë të regjistrimit [REDACTED] nga pakujdesia duke vu në rrezik jetën e njerëzve dhe pasuritë e tyre, ashtu që duke vepruar në kundërshtim me nenin 41 par. 1 të Ligjit mbi Trafikun Publik, gjatë kyçjes në komunikacion duke mos u siguruar se nuk është duke i rrezikuar dhe penguar pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, ndërmerr veprimin e ndërrimit të shiritit nga ana e djathë për në anën e majtë, e pastaj e merr veprimin e kthimit djathtas, ku këtë veprim e bënë pa u bindur që më parë nuk i pengon dhe rrezikon pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion dhe gjatë këtij veprimi del në shiritin

e mëparshëm dhe për pasojë goditet nga motoçikleta "Peugeot Speedfighter", e cila e kishte bllokuar shiritin e vetë të qarkullimit, ashtu që nga kjo goditje i dëmtuari [REDACTED] pëson ndrydhje të indeve të buta të regionit të belit, nëngjurit të djathtë dhe shputës së djathtë të dy gjunjëve, ku si të tilla bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin,-

-me të cilën ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,23,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së:

GJ Y K O N

Të pandehurin, me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënim me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjtë do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Te dëmtuarën [REDACTED] me vendbanim në fshatin [REDACTED] Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzon ne kontest civil.

Detyrohet i pandehuri që për kompensimin e Viktimave të Krimtit ta paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë euro), brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 €, si dhe shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 60.88 € (gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent) në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.2409-8/17 të datës 02.02.2018, ka akuzuar të pandehurin [REDACTED], për vepër penale trezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. I të KPRK-së dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP/II.nr.2409-8/17 të datës 02.02.2018, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata pasi shqyrtoj provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: konstatimi i ekspertit mjeko ligjor Dr. [REDACTED] e datës 26.01.2018, konstatimi dhe mendimi i ekspertit të komunikacionit rrugor ing. [REDACTED] e datës 22.12.2017, skica dhe fotografitë e vendit të ngjarjes-aksidentit të komunikacionit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërtetojnë se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqipton dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi për Kompensimin e Viktimate të Krimít është marrë konform nenit 39 par. 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të Ligjit për Kompensimin e Viktimate të Krimít.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20€, si dhe shpenzimet e procedurës penale në shumë

prej 60.88 €(gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent) në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga arsyet e sipër cekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.243/18, me datë 15.03.2018

Zyrtarja ligjore

Ganimete Avdiu

Gjyqtarja Individuale

Hakile Ilazi



KËSHILLË JURIDIKE:

Kudër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.